

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6810
E premte, 27 janar 2023
çmimi 0.40 €

KMDLNj: Tatimi në pronë apo legalizimi i pronësisë së shtetit mbi plaçkitjen e qytetarëve! | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

I DËRGUARI I POSAÇËM I BASHKIMIT EVROPIAN PËR DIALOGUN KOSOVË - SERBI, MIROSLAV LAJÇAK, KA TAKUAR NË PRISHTINË KRYEMINISTRIN ALBIN KURTI DHE ZËVENDËSIN E TIJ, BESNIK BISLIMI | FAQE 4-5

LAJÇAKU, PAS TAKIMIT ME KURTIN: U PAJTUAM QË TË GJITHA MARRËVESHJET E KALUARA TË ZBATOHEN



I dërguari i posaçëm i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, është takuar në Prishtinë me kryeministrin Albin Kurti dhe

zëvendësin e tij, Besnik Bislimin, me të cilët ka diskutuar për hapat e radhës rreth dialogut. Lajçaku ka bërë me dije se në këtë darkë të punës me Kurtin dhe Bislimin

janë pajtuar që duhen zbatuar plotësisht të gjitha marrëveshjet që janë arritur në dialog, edhe ajo për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe

AKTUALE



TRUMPIT I MUNDËSOHET KTHIMI I LLOGARISË NË "FACEBOOK" DHE "INSTAGRAM" | F. 2

KONFERENCA KIBERNETIKE "CYBER ZERO", KURTI: TRANSFORMIMI DIGJITAL ËSHTË NË FOKUS TË QEVERISJES SONË | F. 7

VAZHDOHET AFATI I KONKURSIT PËR PRANIMIN E POLICËVE TË RINJ NË VERI | F. 7

EKONOMI



PSE ËSHTË RRIUR TATIMI NË PRONË? | F. 8

SPORT



KF LLAPI PËRFUNDON PËRGATITJET NË TURQI, KTHEHET NË KOSOVË | F. 10

BRITANIA E MADHE: KOSOVA TË PRANOHET NË KËSHILLIN E EVROPËS | FAQE 7



KOSOVA DHE KROACIA NËNSHKRUAJNË MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI NË FUSHËN E TURIZMIT | FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Macedoni Xhepçisht -Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

Trumpit i mundësohet kthimi i llogarisë në "Facebook" dhe "Instagram"

UASHINGTON, 26 JANAR - Ish-presidentit amerikan Donald Trump i është mundësuar kthimi i llogarisë në rrjetet sociale "Facebook" dhe "Instagram", pasi kompania amë e tyre, "Meta", ka njoftuar për dhënien fund të pezullimit dyvjeçar.

Vendimi për pezullim të llogarive do të përfundojë "në javët në vijim", ka thënë gjiganti i platformave sociale.

Përmes një deklaratë, Nick Clegg, president i "Meta"-s për çështje të jashtme, ka thënë se publiku "duhet të dëgjojë çfarë thonë politikanët".

Trumpit i ishte pezulluar qasja në "Facebook" dhe "Instagram" për afat të pacaktuar pas trazirave në Kongresin amerikan më 2021.

Clegg ka thënë se kompania ka vepruar pas "lëvdave" të Trumpit "për njerëzit e përfshirë në trazira".

"Pezullimi ka qenë vendim i jashtëzakonshëm, që është

marrë në kushte të jashtëzakonshme", ka shtuar ai. Ai ka thënë se në gjetjet e fundit është kuptuar që llogaritë e Trumpit nuk përbëjnë më rrezik serioz për sigurinë publike.

Trump, ndërkohë, ka bërë një postim në rrjetin e vet social, "Truth Social", duke thënë se "Facebook"-u ka humbur "miliarda" dollarë, pasi ka bllokuar "presidentin tuaj të preferuar, mua".

Lajmi se Trumpit i është kthyer qasja në llogari është kritikuar nga demokratët dhe disa aktivistë, të cilët kanë thënë se Trumpi mund t'i shfrytëzojë sërish llogaritë e tij për të shpërndarë pretendime të rreme.

"Twitter", po ashtu, ia pati bllokuar qasjen Trumpit pas trazirave në Kongres.

Mirëpo në nëntor të vitit të kaluar, shefi i ri i "Twitter"-it, Elon Musk, ka njoftuar për heqjen e ndalesës ndaj Trumpit pas publikimit të një ankete në



këtë platformë.

Trumpi nuk është kthyer në "Twitter", duke thënë se "nuk shoh arsye për të vepruar ashtu". Më 6 janar të vitit 2021 disa protestues kanë hyrë në

ndërtesën e Kongresit amerikan, në përpjekje për ta përmbysur humbjen e Trumpit në zgjedhje.

Trumpi i ka lavdëruar publikisht ata që kanë sulmuar

ndërtesën, mirëpo mohon çdo keqbërje.

Departamenti amerikan i Drejtësisë veçse ka nisur hetime penale për atë që ka ndodhur më 6 janar.

ShBA-ja do t'i dërgojë Ukrainës tanke M1 Abrams

PRISHTINË, 26 JANAR - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, tha se shteti i tij do t'i dërgojë Ukrainës 31 tanke M1 Abrams teksa Kievi po vazhdon të përballet me pushtimin rus për pothuajse 12 muaj.

Duke folur në një konferencë për medie në Uashington, Bideni tha më 25 janar se aftësitë blinduese kanë qenë kritike për Ukrainën për të luftuar kundër një kundërshtari më të madh. Megjithatë, Bideni tha se kjo lëvizje nuk është "një kërcënim për Rusinë". Ai shtoi se ShBA-ja do t'i trajtojë trupat ukrainase "sa më shpejt që të jetë e mundur".

Vendimi i Uashingtonit për të dërguar tanke në Ukrainë vjen po të njëjtën ditë që Gjermania i dha dritën e gjelbër dërgimit të tankeve të llojit Leopard.

Moska ka paralajmëruar se furnizimi i Ukrainës me tanke moderne perëndimore përbën një provokim të rrezikshëm.

Duke folur nga Shtëpia e Bardhë, Bideni tha se tanket e NATO-s për Ukrainën do të ndihmojnë që ukrainasit "ta përmirësojnë aftësinë e tyre për të manovruar në terren të hapur".

Ai foli edhe për vendimin e Gjermanisë për të dërguar tanke në Ukrainë.

Bideni shtoi se "pritja nga ana e Rusisë është se ne do të ndahemi, por ne jemi plotësisht të bashkuar". Vendimi i ShBA-së erdhi menjëherë pasi Gjermania ra dakord të dërgonte 14 tanke Leopard 2 A6 nga rezervat e saj.



Gjermania, duke mos dashur ta nxiste zemërimin e Rusisë, më herët kishte refuzuar të dërgonte Leopardët. Dërgimi i tyre ishte thënë se do të mund të bëhej vetëm nëse edhe ShBA-ja do të vendoste të dërgonte tanket Abrams.

Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, falënderoi presidentin e ShBA-së dhe popullin amerikan për ndihmën dhe shtoi se ishte një hap i rëndësishëm në rrugën drejt fitores. "Sot bota e lirë është e bashkuar si kurrë më parë në një qëllim të përbashkët - çlirimin e Ukrainës. Le të shkojmë përpara", shkroi Zelensky në "Twitter".

Kreu i administratës presidenciale të Ukrainës, Andriy Yermak, reagoi

ndaj vendimit të ShBA-së duke e quajtur atë si "ditë historike" që do të ndihmojë në përcaktimin e rezultatit të luftës. "Gjëja kryesore është se ky është vetëm fillimi. Ne kemi nevojë për qindra tanke", tha Yermak në një postim në "Telegram". "Është një ditë historike. Një nga ato ditë që do ta përcaktojnë fitoren tonë të ardhshme", shtoi ai.

Paketa prej 400 milionë dollarësh, e paralajmëruar të mërkurën, përfshin gjithashtu tetë automjete shpëtimi M88 - zvarritës, të ngjashëm me tanket, që mund ta tërheqin tankun Abrams në qoftë se ai ngec, raporton AP.

Franca, Mbretëria e Bashkuar, Shtetet e Bashkuara të Amerikës,

Polonia, Gjermania, Holanda dhe Suedia do të dërgojnë qindra tanke dhe automjete të blinduara të rënda për ta forcuar mbështetjen për Ukrainën ndërsa ajo hyn në një fazë të re të luftës dhe përpjekje të depërtojë në linjat e përforcuara ruse.

Edhe pse tanket amerikane i janë premtuar Ukrainës, AP shkruan se ka të ngjarë të kalojnë shumë muaj para se të jenë në fushën e betejës dhe jo në kohën e duhur për ofensivën e pritshme pranverore të Rusisë.

Ambasadori rus në Gjermani, Sergei Nechayev, të mërkurën e quajti "jashtëzakonisht të rrezikshëm" vendimin e Berlinit për të dërguar tanke Leopard 2 në

Ukrainë.

Nechayev tha në një deklaratë në internet se ky veprim "e çon konfliktin në një nivel të ri konfrontimi dhe bie ndesh me deklaratat e politikanëve gjermanë për hezitimin e tyre për t'u përfshirë".

Deri më tani ShBA-ja i ka rezistuar dërgimit të tankeve M1 Abrams në Ukrainë, duke përmendur sfidat e gjera dhe komplekse të mirëmbajtjes dhe logistikës.

Uashingtoni beson se do të ishte më produktiv dërgimi i Leopardëve gjermanë, pasi shumë aleatë i kanë ato tanke dhe trupat ukrainase do të kishin nevojë për më pak trajnim.

Që Abrams të jetë efektiv në Ukrainë, forcat e tij do të kërkojnë trajnim të gjerë për manovrimin e armëve të kombinuara - se si tanket punojnë së bashku në fushën e betejës dhe si ta mirëmbajnë dhe mbështesin armën komplekse me peshë 70 tonë, raporton AP.

Para njoftimit, Bideni zhvilloi një bisedë me presidentin francez Emmanuel Macron, kancelarin gjerman Olaf Scholz, kryeministrin italian Giorgio Meloni dhe kryeministrin britanik Rishi Sunak, njoftoi Shtëpia e Bardhë.

Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky vazhdimisht u ka bërë thirrje aleatëve perëndimorë që ta furnizojnë shtetin e tij me armatim, përfshirë tanket më moderne, duke thënë se "nevoja për të është shumë e madhe".

Britania e Madhe: Kosova të pranohet në Këshillin e Evropës

Prishtinë, 26 janar - Kosova duhet të lejohet të ecë përpara për anëtarësim në Këshillin e Evropës, tha përfaqësuesi i Britanisë së Madhe, John Howell, në seancën e Asamblesë Parlamentare të kësaj organizate ndërkombëtare.

Këshilli i Evropës është organizatë ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, demokracinë dhe sundimin e ligjit, me seli në Strasburg të Francës.

Në një debat të mbajtur me iniciativën e Britanisë së Madhe në selinë e Këshillit të Evropës, Howell kërkoi që çështja e anëtarësimit të Kosovës të ndahet nga progresi në dialogun e Kosovës me Serbinë, i cili ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian (BE). “Kosova nuk duhet të mbahet peng në raport me progresin në dialogun e udhëhequr nga BE-ja. Duhet të tregojmë se Këshilli i Evropës është i ndarë nga Bashkimi Evropian dhe se ka vlerat dhe parimet e veta mbi bazën e të cilave sillen vendimet”, tha Howell në fjalën e tij. Gjatë seancës, Shqipëria,



Maqedonia e Veriut dhe Kroacia mbështetën anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës, ndërsa Serbia u bëri thirrje

anëtarëve që ta refuzojnë kërkesën e Kosovës. Kosova e ka dorëzuar kërkesën për anëtarësim në Këshillin e

Evropës në maj të vitit 2022. Serbia e kundërshton anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës dhe në institucione dhe

organizata të tjera ndërkombëtare dhe në mënyrë aktive është duke bërë fushatë për tërheqjen e njohjeve të pavarësisë së Kosovës. Në këtë fushatë Serbia ka aleatë Rusinë, e cila u përjashtua nga Këshilli i Evropës në mars të vitit 2022 për shkak të pushtimit të Ukrainës.

Pa Rusinë dy të tretat e shteteve anëtare të asaj organizate e njohin pavarësinë e Kosovës.

Nëse merret parasysh se vendimet sillen me shumicën e votave të shteteve anëtare, mundësia që Kosova të anëtarësohet në Këshillin e Evropës është reale.

Gjatë debatit, anëtarët e Asamblesë së Këshillit të Evropës shprehën shqetësimin për tensionet në marrëdhëniet ndërmjet Serbisë dhe Kosovës dhe rolin e Rusisë dhe presidentit të saj Vladimir Putin në këtë situatë. “Nëse është kështu, ne duhet të jemi të vetëdijshëm për këtë dhe të ndërmarrim hapa konkretë”, tha përfaqësuesi i Britanisë së Madhe, John Howell.

Konferenca kibernetike “Cyber zero”, Kurti: Transformimi digjital është në fokus të qeverisjes sonë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 26 JANAR - “Transformimi digjital në të cilin jemi duke punuar do të sjellë benefite të shumta si për shtetin, po ashtu edhe për shoqërinë. Digjitalizimi i administratës publike në veçanti mundëson rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në qeverisje si dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve për qytetarët dhe bizneset tona, andaj është edhe në fokus të qeverisjes sonë. Përmes digjitalizimit në arsim ne synojmë arsim më cilësor në të gjitha nivelet, ndërsa sistemi i informacionit shëndetësor do të krijojë mundësi për shëndetësi më efikase. Me digjitalizim të gjithëmbarshtëm presim rritje të kursimeve, të produktivitetit dhe të konkurrueshmërisë në ekonomi”, ka thënë kryeministri Albin Kurti në konferencën ndërkombëtare të sigurisë kibernetike “Cyber zero”. Me këtë rast, kryeministri Kurti ka njoftuar se qeveria është duke i adresuar rreziqet e sigurisë kibernetike përmes një angazhimi



shumëdimensional dhe shtoi se në tetor të vitit të kaluar është miratuar në qeveri Ligji për Sigurinë Kibernetike si dhe është aprovuar në lexim të parë në Kuvend. Ai ka theksuar se përmes këtij ligji do të

themelohet Agjencia për Siguri Kibernetike, që do të jetë institucioni kyç përgjegjës për caktimin dhe zbatimin e masave për siguri kibernetike në Republikën e Kosovës.

Ndërsa sipas Kurtit, është finalizuar drafti i strategjisë së re për sigurinë kibernetike, që pritet të vendoset në konsultime publike në fund të këtij muaji, për çka kryeministri i ka inkurajuar të gjithë që të marrin

pjesë. “Strategjia rritë domosdoshmërinë e forcimit të mekanizmave institucionalë dhe rritjes së kapaciteteve të qëndrueshme njerëzore në fushën e sigurisë kibernetike në nivel të shtetit. Në veçanti, parashihet rritja e kapaciteteve për trajtimin e incidenteve kibernetike në luftimin e krimit kibernetik”, ka thënë ai.

Më tej, kryeministri Kurti ka thënë se mbrojtjen efektive të vendit në fushën e sigurisë kibernetike do të mund ta bëjmë vetëm përmes një bashkëpunimi të ngushtë e të dendur ndërmjet sektorit publik e privat, akademisë e komunitetit të gjerë të sigurisë kibernetike në vend, si dhe bashkëpunimit ndërkombëtar me vendet mike, e gjithësi edhe konferenca “Cyber Zero” i kontribuon një bashkëpunimi të tillë.

Në fund, duke vënë theksin te rëndësia e sigurisë kibernetike, ai shtoi se Republika e Kosovës do ta shtojë investimin e saj në mbrojtje dhe siguri, por se as mbrojtja e as siguria nuk janë të mbrojtura e të sigurta përdërisa nuk ka siguri kibernetike.

Reka takon përfaqësues të Indonezisë, shtet ky që ende nuk e ka njohur Kosovën

Nju-Jork, 26 janar - Shefi i Misionit në Konsullatën e Përgjithshme të Republikës së Kosovës në Nju-Jork, ambasadori Blerim Reka, ka takuar të mërkurën konsullin e përgjithshëm të Indonezisë në Nju-Jork, Winanto Adi, shtet ky që ende nuk e ka njohur

pavarësinë e Kosovës. Ky takim i Rekës ka ndodhur me rastin e festës shtetërore të Australisë në Nju-Jork. “Mbrëmë në pritjen për festën shtetërore të Australisë, me ambasadorin Mitch Fifield, Përfaqësuesin e Përhershëm të Australisë në OKB dhe Nick

Greiner, Konsullin e Përgjithshëm të Australisë në Nju-Jork. Takim miqësor me shtetin mik të Kosovës. Nga shumë takime, kënaqësi të bisedoja edhe me Winanto Adi, Konsullin e Përgjithshëm të Indonezisë në Nju-Jork”, ka shkruar Reka në “Facebook”.





I DËRGUARI I POSAÇËM I BASHKIMIT EVROPIAN PËR DIALOGUN KOSOVË - SERBI, MIROSLAV LAJÇAK, KA TAKUAR NË PRISHTINË KRYEMINISTRIN ALBIN KURTI DHE ZËVENDËSIN E TIJ, BESNIK BISLIMI

Lajçaku, pas takimit me Kurtin: U pajtuam që të gjitha marrëveshjet e kaluara të zbatohen

I dërguari i posaçëm i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, është takuar në Prishtinë me kryeministrin Albin Kurti dhe zëvendësin e tij, Besnik Bislimin, me të cilët ka diskutuar për hapat e radhës rreth dialogut. Lajçaku ka bërë me dije se në këtë darkë të punës me Kurtin dhe Bislimin janë pajtuar që duhen zbatuar plotësisht të gjitha marrëveshjet që janë arritur në dialog, edhe ajo për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 26 JANAR - I dërguari i posaçëm i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, në orët e vona të së mërkurës është takuar në Prishtinë me kryeministrin Albin Kurti dhe zëvendësin e tij, Besnik Bislimi, me të cilët ka diskutuar për hapat e radhës për normalizim të marrëdhënieve mes dy vendeve. Lajçaku ka publikuar një fotografi në rrjetin social "Twitter" me kryeministrin Kurti dhe zëvendëskryeministrin Bislimi gjatë darkës së punës. Ai ka shkruar mbi këtë fotografi se janë pajtuar që të gjitha marrëveshjet e kaluara të

zbatohen plotësisht. "Ne jemi pajtuar që të gjitha marrëveshjet e kaluara që janë arritur në dialog duhet të zbatohen plotësisht", ka shkruar Lajçaku. Kryeministri Albin Kurti ka thënë të enjten se me Lajçakun kanë diskutuar gjatë për propozimin e BE-së. "Çështje e të drejtave të pakicave, çështja e marrëveshjeve të mëhershme në Bruksel, është përbrenda këtij propozimi të BE-së. Nuk mund ta nxjerrësh qerren para kalit, së pari kali pastaj qerrija. Pra, nuk mund të përzgjedhësh një nen të caktuar, me një interpretim të njëanshëm, dhe ta sjellësh para propozimit. Unë jam i gatshëm të shkoj në Bruksel dhe ta diskutoj propozimin", ka deklaruar Kurti.

Ai ka theksuar se marrëveshja për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe është marrëveshja e vetme e nënshkruar në Bruksel që nuk e ka kaluar testin e Gjykatës Kushtetuese.

Kosova dhe Serbia, nën ndërmjetësim të Bashkimit Evropian, kanë nënshkruar më 2013 marrëveshjen për formimin e asociacionit.

Më 2015 është nënshkruar një marrëveshje tjetër për, siç është thënë, parimet e këtij asociacioni. Po më 2015 Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka gjetur se marrëveshja nuk është në harmoni të plotë me Kushtetutën, por që nenet mund të harmonizohen.

Serbia kërkon që Kosova t'i zbatojë marrëveshjet e arritura, por Qeveria e Kosovës është deklaruar kundër një asociacioni njëetnik. "Ka insistim nga faktorë të ndryshëm ndërkombëtarë që Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe, ashtu siç është nënshkruar më 19 prill 2013, e më pas edhe i elaboruar në shtatë kapituj më 2015, të theksohet më shumë, por ajo marrëveshje është tashmë e theksuar, sepse është e vetmja

marrëveshje, nga 33 marrëveshjet e Brukselit që nuk e ka kaluar testin e Gjykatës Kushtetuese", ka deklaruar Kurti.

Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian insistojnë që Kosova ta zbatojë marrëveshjen e arritur për asociacionin. ShBA-ja ka paralajmëruar se do të kërkojë "partnerë alternativë" për formimin e asociacionit në rast se Qeveria e Kosovës nuk e gjen një mënyrë për ta themeluar atë dhe i kanë kërkuar kësaj të fundit që t'i prezantojë propozimet e veta në këtë temë. "Le të zhvillohen sa më shumë takime e diskutime, mirëpo për normalizim të marrëdhënieve, që na shpjen më afër drejt Bashkimit Evropian, për paqe afatgjatë e stabilitet të qëndrueshëm, për siguri për të gjithë, pa diskriminuar asnjë njeri, na duhet njohja reciproke në qendër. Jo asociacionit në qendër. As asociacionit parakusht, por njohje reciproke në qendër", ka thënë Kurti para gazetarëve.

Kurti ka folur edhe për propozimin e Bashkimit Evropian për normalizimin e marrëdhënieve në të mes Kosovës dhe Serbisë, duke thënë se ai duhet ta ketë njohjen

reciproke në qendër. "Diplomacia fluturuese u është bashkëngjitur takimeve të nivelit të lartë për propozimin e Bashkimit Evropian, të mbështetur nga Franca, Gjermania dhe Shtetet e Bashkuara. Ky propozim i ka pesë fjali në preambulë dhe 10 nene".

Diplomacia fluturuese (shuttle) nënkupton takimet e shpeshta të diplomatëve të huaj, në përpjekje për t'i përafuar qëndrimet e palëve. Kurti ka përsëritur se propozimin evropian, që në publik njihet edhe si plani franko-german, e konsideron bazë të mirë për diskutime dhe si "kornizë që na mundëson të ecim përpara".

Këshilltari i Departamentit amerikan të Shtetit, Derek Chollet, ka bërë me dije se e ka inkurajuar kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, që ta pranojë propozimin e BE-së për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë. Në bisedën përmes telefonit me Kurtin, e cila u realizua dy ditët e fundit, zyrtari amerikan ka theksuar se kanë folur edhe për rëndësinë e karakterit shumëetnik të Kosovës dhe ecjen përpara me diskutime për Asociacionin e

Kosova dhe Kroacia nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi në fushën e turizmit



Prishtinë, 26 janar - Në kuadër të Forumit Ekonomik Kosovë - Kroaci, është nënshkruar të enjten në Prishtinë marrëveshja e bashkëpunimit mes dy shteteve në fushën e turizmit. Kryeministri Albin Kurti ka theksuar se Republika e Kosovës mbetet e përkushtuar për forcimin e bashkëpunimit dhe marrëdhënieve të shkëlqyera që ka me Republikën e Kroacisë si

mike dhe partnere strategjike e vendit tonë. Ai ka vlerësuar lart marrëdhëniet e mira me Kroacinë duke thënë se, pos gjeografikisht, lidhshmëria ekziston edhe politikisht e historikisht. "Jemi dy vende të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën politikisht, historikisht por edhe gjeografikisht. Ka ardhur koha t'i forcojmë edhe lidhjet tona në ekonomi. Pasi i shqyrtova lidhjet

tona të shkëmbimeve tregtare ndihem i sigurt që jemi në rrugën e duhur për ta bërë këtë dhe ta kapim këtë mundësi që të kemi një lidhje të jashtëzakonshme në vitin 2023", u shpreh Kurti.

Kurti ka theksuar se eksporti me Kroacinë është trefishuar, ndërsa importi është dyfishuar. "Eksportet tona me Kroacinë janë trefishuar, ndërsa importet

nga Kroacia janë dyfishuar. Për momentin janë më shumë se 160 kompani kroate që po shërbejnë në Kosovë me rreth 650 punëtorë. Jam i sigurt që këto shifra veç sa do të rriten në vijim", ka deklaruar ai.

Rozeta Hajdari, ministre e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ka thënë se synojnë rritjen e shkëmbimeve tregtare me Kroacinë. Hajdari ka thënë se

themelet e bashkëpunimeve Kosovë - Kroaci janë të kahershme. "Ky forum kontribuon në synimin tonë për rritjen e shkëmbimeve tregtare dhe krijimin e raporteve biznes-biznes ndërmjet Kosovës dhe Kroacisë pasi të dyja vendet kanë një potencial për më shumë shkëmbime tregtare dhe bashkëpunim ekonomik", ka deklaruar ministria Hajdari.

Komunave me Shumicë Serbe.

"Një temë kyçe ka qenë partneriteti ynë dhe synimi i përbashkët për avancimin e integritet evropian dhe euroatlantik të Kosovës", ka shkruar Chollet.

Ai ka theksuar se me Kurtin ka biseduar edhe për çuarjen përpara të diskutimeve për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë. "Ne diskutuam, gjithashtu, për rëndësinë e karakterit multi-etnik të Kosovës dhe ecjen përpara me diskutime për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe në kontekstin e dialogut me Serbinë dhe nevojën që serbët e Kosovës të kthehen në

institucione", ka shkruar Chollet.

Ambasadori gjerman në Prishtinë, Jorn Rohde, tha se "pajtohet plotësisht" me deklaratat e këshilltarit të Departamentit amerikan të Shtetit, Derek Chollet, sa i përket shtyrjes përpara të diskutimeve për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë. "Jam plotësisht dakord: është shumë e rëndësishme ta çojmë përpara diskutimin për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe. Është mirë të dëgjosh se ministri i Kosovës, Nenad Rashedi, ka konfirmuar pjesëmarrjen e tij në diskutimin e planifikuar për këtë çështje më 31

janar në Ambasadën Amerikane në Prishtinë", tha ambasadori gjerman.

Analisti Daniel Serwer ka deklaruar se versioni i fundit i planit franko-gjerman për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi, në të cilën, siç thotë ai, përfshihen më shumë detaje rreth rregullimit të jetës së komunitetit serb në Kosovë, mirëpo nuk përmendet njohja e Kosovës nga pesë shtetet e BE-së dhe as çështja e të drejtave të komunitetit shqiptar në Serbi.

Serweri ka theksuar se versioni i fundit i këtij plani është një "hap kah drejtimi i duhur" nëse zbatohet plotësisht, por ka "shitesa

të diskutueshme" dhe të meta.

Profesori nga Universiteti "John Hopkins" në Uashington shtoi se në nenin 7 thuhet se të dyja palët janë të përkushtuara për arritjen e marrëveshjeve konkrete në përputhje me instrumentet përkatëse të Këshillit të Evropës dhe duke përdorur përvojat ekzistuese evropiane "për të siguruar një nivel të duhur të vetëqeverisjes për komunitetin serb në Kosovë dhe mundësia e ofrimit të shërbimeve për Kosovën", siç u tha, në fusha të caktuara, duke përfshirë mundësinë e ndihmës financiare nga Serbia dhe kanalet e

drejtëpërdrejta të komunikimit ndërmjet komunitetit serb dhe Qeverisë së Kosovës.

Në pjesën e atij shkrimi të publikuar nga Serweri thuhet se palët do ta zyrtarizojnë statusin e Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë dhe do të sigurojnë një nivel të lartë të mbrojtjes së trashëgimisë fetare dhe kulturore serbe në përputhje me modelet ekzistuese evropiane. Ai deklaroi se një nga mangësitë është se paragrafi i parë nuk e përmend Kushtetutën e Kosovës si bazë për "aranzhimet konkrete" të përmendura dhe se reciprociteti brenda Serbisë nuk kërkohet për komunitetin shqiptar.

Reagim i KMDLNj-së

Tatimi në pronë apo legalizimi i pronësisë së shtetit mbi plaçkitjen e qytetarëve!

KMDLNj-së i janë drejtuar shumë qytetarë pas vendimit që faturat e tatimit në pronë, krahasuar me vitin 2022 janë rritur deri më 120 për qind më shumë. Pas këtij veprimi prej kusarëve të Ministrisë së Financave, komunat i kanë bërë publike faturat e tatimit për pronë për vitin 2023, duke u arsyetuar se përgjegjësia bie mbi Ministrinë për Financa që e paska bërë rivlerësimin e pronave dhe se komunat janë të detyruara të zbatojnë vendimin e kësaj ministrie ndonëse, gjithnjë sipas deklaratave të kryetarëve të komunave, ata nuk qenkan pajtuar me këtë vendim. Qytetari i Kosovës është futur në gërshtë midis dy mashtruesve, Ministrisë së Financave dhe komunave të cilët ua hedhin përgjegjësinë njëra-tjetër derisa faturat janë me shifra të papërbalueshme për shumicën e qytetarëve të Kosovës. Ministria e Financave nuk e ka bërë as veprimin simbolik për t'ua lehtësuar gjendjen e rënduar ekonomike pjesës më të madhe të qytetarëve të Kosovës në kohën kur inflacioni ka kaluar 12 për qind kurse çmimet e artikujve të domosdoshëm elementarë për shumicën e qytetarëve të Kosovës janë rritur mbi 50 për qind. Të gjitha shërbimet janë rritur që nga sigurimet e automjeteve, karburantet, shërbimet bankare, shërbimet shëndetësore, çmimet e barnave, biletat në trafik kurse, në anën tjetër nuk kemi rritje të pagave, pensionet janë më të ulëta në rajon, asistencë sociale që ofron qeveria është simbolike, bizneset kanë falimentuar apo janë buzë falimentimit ndërsa

përkrahen, një herë në vit me nga 50 euro të punësuarit në sektorin publik kurse dhunohen të drejtat e të punësuarve në sektorin privat duke mos u përkrahë asnjëherë dhe, së fundi, në vend se të ketë lehtësira për këtë gjendje të rënduar ekonomike të qytetarëve, Ministria e Financave, pandershmërisht godet qytetarët duke ua dyfishuar faturat e tatimit në pronë. Qytetarët kundërligjshëm detyrohen që tatimin në pronë ku përfshihet periudha një vjeçare, ta shlyejnë në afatin nëntë mujor dhe, nëse vonoheni për t'i paguar faturat në afatet e parapara, atëherë do të gjobiteni me shumë 0.65 centë për një ditë dhe 10 për qind nga vlera e faturës së tatimit në pronë. Tatimi në pronë sidomos ka treguar rritje jonormale në komunën e Prishtinës e cila edhe në fushat tjera ka krijuar mekanizma të kundërligjshëm për të plaçkitur qytetarët e Prishtinës dhe ata që e vizitojnë Prishtinën. Në Prishtinë vepron një njësi paramilitare që ishte formuar pa asnjë bazë ligjore nga qeveria paraprake komunale e quajtur "Prishtina Parking" e cila, në kundërshtim të plotë me ligjin e merr rolin e inspektoratit, të policisë së trafikut rrugor, të prokurorit dhe të gjykatësit ku, vet të dënon dhe vet të ekzekuton. Çmimet i kanë në nivel të kryeqendrave evropiane dhe botërore dhe kanë gllabëruar çdo hapësirë që janë të caktuara për qytetarët, madje edhe trotuarët ku kanë vendosur matësit e parkingut ndonëse me asgjë nuk ngjajnë një



vendparkimi. Kjo dukuri është e theksuar sidomos në Dardani, Lagjen Bregu i Diellit dhe në Ulpianë ku edhe hapësirat për këmbësorë janë shndërruar në vendparkim. Pastaj, nëse qytetarët e Prishtinës janë të detyruar ta paguajnë tatimin enorm për pronë si dhe taksën rrugore, pse u dashka të paguajnë taksën për parkim për hapësirat që edhe ashtu tatimohen. Pastaj, çka ka investuar komuna e Prishtinës në këto hapësira që terrorizohen nga paramilitarët e Prishtina Parking për të vjel një taksë ndëshkuese?! KMDLNj është kundër veprimit plaçkitës të Ministrisë së Financave për tatimin në pronë e që është në kundërshtim të plotë me gjendjen aktuale ekonomike

për shumicën e qytetarëve të Kosovës sikur edhe kundër veprimeve arbitrare të Prishtina Parking që gjobit qytetarët e Prishtinës përtej mandatit që duhet ta kishte një kompani që ofron shërbime të kësaj natyre. KMDLNj përkrahë kërkesat e drejta dhe të arsyeshme të qytetarëve kundër rritjes jonormale të faturave të tatimit në pronë si dhe sjelljes arbitrare të Prishtina Parking dhe kërkon që urgjentisht të rishqyrtohet vendimi për rritje të tatimit në pronë. Për këtë duhet të rritet aktivizmi qytetar i cili do të kërkonte nga deputetët e Kuvendit të Kosovës që në një interpelancë të veçantë të kërkojnë sqarime nga MF për këtë rritje si dhe rikthimin e tatimit në gjendje të mëparshme

për aq kohë sa do ta kemi këtë gjendje të rënduar ekonomike. Në të njëjtën kohë ky aktivizëm qytetar, i munguar por se mund dhe duhet të aktivizohet, duhet të bëjë presion dhe kërkojë që asamblistët e Komunës së Prishtinës të trajtojnë rastin e Prishtina Parking duke i disiplinuar që të sillen në përputhje me ligjin dhe duke marrë në përgjegjësi ata që sollën këtë situatë. Mirëpo, nëse nuk do të kishte asnjë ndryshim, atëherë qytetarët duhet të vetorganizohen dhe të kërkojnë realizimin e të drejtave njerëzore të tyre përmes mosbindjes qytetare dhe kundërshtimeve tjera si protesta paqësore, marshe paqësore e që zbatohen në të gjitha vendet demokratike.

Komunën e Mitrovicës e përkrahin donatorët pas vërshimeve



MITROVICË, 26 JANAR - Komuna e Mitrovicës po vazhdon përkujdesjen ndaj qytetarëve me pako ushqimore dhe higjienike për familjet dhe qytetarët e prekur nga vërshimet e fundit. Këto ndihma po dhurohen falë kontributit të dhënë nga njerëz vullnetmirë, donatorë dhe organizata bamirëse, me ç'rast komuna këto ditë ka pranuar edhe 405 pako ushqimore të tjera, me qëllim që sadopak të ndihmohen familjet e dëmtuara nga vërshimet.

Me këtë rast, ekipet komunale kanë bërë shpërndarjen e 350 pakove ushqimore dhe bidonave me ujë, donacion ky nga Qendra Tregtare ETC, 50 pako ushqimore dhe higjienike nga Shoqata "Jetimat e Ballkanit", 5 pako ushqimore nga Shoqata "Inciativa" (donator anonim), si dhe Këshilli Lokal i Koretinit nga komuna e Kamenicës dhe komuna e Çairit kanë dhuruar ndihma të konsiderueshme duke përfshirë pako ushqimore, gjëra elementare

dhe veshmbathje. Po ashtu, janë shpërndarë 100 shujta të ngrohta, këto të dhuruara nga Shoqata "Zgjatma Dorën", 70 shujta të ngrohta nga donatorë anonimë nga qyteti i Vushtrisë, ndërsa 50 jorganë dhe 50 jastëk nga "Broja Market". Komuna e Mitrovicës falënderon të gjithë donatorët, organizatat bamirëse dhe ata që kontribuuan për t'u dalë në ndihmë qytetarëve të cilët janë prekur nga vërshimet.

Kuvendi Komunal i Drenasit i jep mbështetje iniciativës që lulëkuqja të bëhet simbol i gjenocidit

DRENAS, 26 JANAR - Në mbledhjen e 25 janarit, Kuvendi Komunal i Drenasit i ka dhënë mbështetje unanime kërkesës të cilën

Qendra "Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur" ua ka drejtuar institucioneve të Kosovës, që lulëkuqja me katër petale të bëhet simbol

unik përkujtimor i viktimave të gjenocidit në Kosovë. Qendra "Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur"

falënderon Kuvendin Komunal të Drenasit si dhe të gjithë asamblistët e saj për unitetin e treguar në këtë mbështetje të rëndësishme.



Jep dorëheqje drejtoresha e ShSKUK-së, Pranvera Zejnullahu-Raçi

PRISHTINË, 26 JANAR - Pranvera Zejnullahu-Raçi ka dhënë dorëheqje nga pozita e ushtrueses e drejtorit të Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës. "Ju njoftojmë se Bordi Drejtues i ShSKUK-së, në mbledhjen urgjente të mbajtur më 26.01.2023, ka shqyrtuar letër-dorëheqjen e u.d. drejtorit të

përgjithshëm të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK), dr. Pranvera Zejnullahu-Raçi, me numër protokollit 289, të datës 26.01.2023, dhe të njëjtën e ka miratuar. Po ashtu, ju njoftojmë se, bazuar në kompetencat e veta, Bordi Drejtues i ShSKUK-së ka emëruar zëvendësuesin e drejtorit të përgjithshëm të

Shërbimit Spitalor Universitar të Kosovës, dr. Narqize Arenliu-Hoxhaj", është bërë me dije në njoftimin e ShSKUK-së.

Bordi Drejtues i ShSKUK-së ka vlerësuar kontributin e deritanishëm të dr. Pranvera Zejnullahu-Raçi, duke e falënderuar për bashkëpunimin e treguar.



Vazhdohet afati i konkursit për pranimin e policëve të rinj në veri

Mitrovicë, 26 janar - Policia e Kosovës e ka vazhduar afatin e konkursit për punësimin e pjesëtarëve të rinj nga komunitetet joshumicë për t'i plotësuar pozitat e lira në Drejtorinë Rajonale të Policisë së Kosovës në Mitrovicën e Veriut. Konkursi, që fillimisht është shpallur nga 5 deri më 26 janar, do të shtyhet deri më 10 shkurt, ka konfirmuar Policia e Kosovës për "Radion Evropa e Lirë".

Mirëpo ky institucion nuk ka ofruar hollësi se sa aplikacione ka pranuar deri më tani, nëse ka aplikuar dikush nga radhët e komunitetit serb, apo ish-policët nga veriu i Kosovës që kanë dhënë dorëheqje nga pozitat e tyre në nëntor të vitit të kaluar. Policia ka thënë shkurtimisht se kriteret për punësimin e punonjësve të rinj të policisë mbeten të njëjta dhe se publiku do të informohet me kohë për hapat e mëtejshëm. "Policia e

Kosovës, përmes videomesazheve, fushatave sensibilizuese dhe takimeve zyrtare që po mbahen në të gjitha rajonet, çdoherë ka inkurajuar dhe vazhdon t'i inkurajojë dhe i fton qytetarët e të gjitha komuniteteve pakicë që të aplikojnë dhe të bëhen pjesë e Policisë së Kosovës", është thënë në përgjigjen e Policisë.

Qeveria e Kosovës pati bërë me dije më 12 janar se konkursi për rekrutimin e policëve të rinj është i hapur për të gjithë ata që i plotësojnë kriteret dhe se Kosova nuk dëshiron ta përjashtojë askënd nga institucionet apo t'i "zëvendësojë serbët me shqiptarë".

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i ka ftuar pjesëtarët e komunitetit serb, veçanërisht ata që nuk kanë punuar asnjëherë në institucionet e Kosovës, të aplikojnë në



konkurs. Ky konkurs është shpallur pas dorëheqjes së rreth 550 serbëve nga pozitat e tyre në veri të

Kosovës, në nëntor të vitit 2022, si shenjë pakënaqësie ndaj vendimit të Qeverisë së Kosovës për t'i reregjistruar makinat me

targa serbe në RKS - Republika e Kosovës. Megjithatë, në konkurs nuk përmendet numri i policëve të rinj që do të punësohen.

Dekorohet me Medaljen Presidenciale Ushtarake komandanti i Gardës Kombëtare të Iowas



Prishtinë, 26 janar - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të enjten në takim një delegacion të ShBA-së, i prirë nga gjeneralmajor Benjamin J. Correl, komandant i Gardës Kombëtare të Iowas, ambasadori amerikan Jeffrey Hovenier dhe zyrtarë të tjerë të lartë të mbrojtjes.

Pasi që ka falënderuar gjeneralmajorin Correl për gjithë angazhimin e tij në fushën e bashkëpunimit bilateral

ndërmjet FSK-së dhe Gardës Kombëtare të Iowas, si dhe kontributin në fushën e mbrojtjes së Republikës së Kosovës dhe qytetarëve të saj, presidentja Osmani e ka dekoruar me Medaljen Presidenciale Ushtarake.

Presidentja Osmani tha se Programi i Bashkëpunimit në fushën e Sigurisë i Departamentit të Mbrojtjes të ShBA-së, i kryesuar nga Byroja e Gardës

Kombëtare, respektivisht partneriteti shtetëror me Iowan, është thelbësor për marrëdhëniet strategjike me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Në këtë kontekst ajo ka çmuar angazhimin e deritashëm të gjeneralmajorit Correl, duke shfaqur shpresën se marrëdhëniet në fushën e sigurisë ndërmjet dy shteteve vetëm sa do të thellohen në të ardhmen.

Më 2 shkurt shpallet vendimi i Apelit për Gucatin dhe Haradinajn

Hagë, Prishtinë, 26 janar - Javën e ardhshme, respektivisht më 2 shkurt, 261 ditë pas vendimit të shkallës së parë, paneli i Gjykatës i Apelit do ta bëjë shpalljen e aktgjykimit të Apelit në çështjen Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj.

Më 18 maj 2022 është shpallur aktgjykimi ndaj Hysni Gucati dhe Nasim Haradinajt, ku trupi gjyqësor i shpalli fjalorë për

pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, frikësim gjatë procedurës penale dhe shkelje të fshehtësisë së procedurës, raporton "Betimi për Drejtësi". Ata janë dënuar me nga katër vjet e gjysmë burgim, ku do të llogaritet koha e kaluar në paraburgim, dhe me gjobë prej 100 eurosh për secilin. Ndërkaq, u liruan nga

përgjegjësia penale për hakmarrje.

Hysni Gucati së bashku me Nasim Haradinaj akuzoheshin për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë, konkretisht për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, për frikësim të dëshmitarëve, për hakmarrje dhe për shkelje të fshehtësisë së procedurës.



Pse është rritur tatimi në pronë?



PRISHTINË, 26 JANAR - Nëse ju është rritur tatimi vjetor në pronë ditët e fundit, kjo domethënë se është rritur vlera e pronës suaj. Këtë e ka konstatuar Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) pas vlerësimit që e ka bërë vitin e kaluar.

Rritja e vlerësimit të pronave në treg ka rritur automatikisht pagesën e tatimit në pronë për qytetarët e Kosovës.

Tatimi në pronë është taksë vjetore komunale dhe përcaktohet nga shumëzimi i vlerës së pronës me normën tatimore. Normat tatimore vendosen nga komunat përkatëse. Kjo normë është 0.15 për qind të vlerës së përgjithshme të pronës.

Vlerësimi i pronës nga MFPT-ja, sipas ligjit, realizohet në çdo tre ose pesë vjet. Vlerësimin e fundit ministria e bëri vitin e kaluar, kurse zbatimi i tij në tatimin në pronë ka filluar nga janari i këtij viti.

Më herët vlerësimi është bërë në vitin 2019.

Sa është rritur tatimi në pronë?

Për disa, tatimi vjetor në pronë është rritur deri në 100 për qind,

e për disa të tjerë ka mbetur e pandryshuar, sepse vlera e pronës ka mbetur e njëjtë si në të kaluarën. Për shembull, vlera e një banese në lagjen Ulpiana në Prishtinë më herët ka qenë 650 euro për metër katror, kurse vlera e re është 1 200 euro për metër katror. Më herët, pronari i kësaj banese ka paguar tatimin në pronë rreth 27 euro, kurse tash duhet të paguajë 52 euro në vit.

Vlera e pronës ndikohet nga disa faktorë, ndër të tjera, edhe lokacioni apo zona e pronës, kati etj. Në të gjitha komunat e Kosovës ekzistojnë disa zona, ku nga zona në zonë ndryshon çmimi i metrit katror të pronës. Zakonisht çmimet janë më të larta për pronat që gjenden më afër qendrës së qytetit.

Edhe pse vlerësimi është bërë në gjithë territorin e Kosovës, në disa zona nuk ka ndryshuar vlera tatimore. Për shembull, vlera e disa pronave në Çagllavicë afër Prishtinës ka mbetur e pandryshuar.

Në rivlerësimin e fundit të pronave nuk ka ndonjë çmim zyrtar publik se sa kushton metri katror në qytete apo zona të ndara.

Por, në vitin 2019, sipas të dhënave të publikuara në faqen zyrtare të Departamentit të Tatimit në Pronë, që është në

kuadër në Ministrinë e Financave, vërehet se çmimet për metër katror për apartamente ishin vlerësuar nga 130 deri në mbi 800 euro, varësisht nga lokacioni i objektit.

Për çdo vit fiskal tatimi komunal mbi pronën e paluajtshme paguhet në dy këste të barabarta. Nëse personi vonohet me pagesën e faturës, atëherë ngarkohet me gjoba.

Kush e ka bërë vlerësimin e pronave?

“Radio Evropa e Lirë” ka pyetur Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve se në çfarë formash është bërë vlerësimi i pronave dhe, pas vlerësimit, sa është përqindja e rritjes së çmimit të pronave të paluajtshme, por deri në publikimin e këtij artikulli nuk ka marrë përgjigje. Megjithatë, në një komunikatë për medie të MFPT-së, më 24 janar, thuhet se ministria obligohet ta bëjë vlerësimin e pronave, ndërsa shkallën e tatimit e përcaktojnë vetë komunat.

“Departamenti i Tatimit në Pronë, në kuadër të kësaj ministrie gjatë vitit 2022, ka kryer vlerësimin e përgjithshëm të tokave dhe objekteve

rezidenciale si dhe ka përpiluar raporte të vlerësimit për prona rezidenciale me datë 31.10.2022, për të cilat janë njoftuar të gjitha komunat”, thuhet në komunikatë.

Përgjatë vlerësimit të pronave rezidenciale thuhet se ky departament ka bashkëpunuar ngushtë me komunat për ta përcaktuar çmimin për metër katror për objekte dhe toka.

Prona rezidenciale llogariten pronat e paluajtshme, të cilat u shërbejnë njerëzve për nevoja themelore të banimit, duke përfshirë: shtëpitë, banesat dhe ndërtesat e ngjashme.

Sazan Ibrahim, drejtor ekzekutiv i Asociacionit të Komunave të Kosovës, tha se komunat nuk janë konsultuar për rivlerësimin e pronave. “Komunave vetëm iu ka shkuar njoftimi në fund të muajit tetor të vitit të kaluar se është bërë rivlerësimi i pronave dhe kjo është mënyra se si në të ardhmen duhet të jetë çmimi i faturave. Pra, komunat vetëm janë njoftuar dhe nuk janë konsultuar, këtu është dallim i madh...”, tha Ibrahim.

Vlerësimi i përgjithshëm thuhet se është realizuar duke u bazuar në vlerën e tregut, duke përdorur kontratat e shitblerjeve për pronat rezidenciale (jo më të vjetra se

tre vjet), intervista me agjentë të shitjes së pronave, anketime me pronarë të ndërtesave, intervista me zyrtarë të bankave në lidhje me vlerat e pronave që përdorin si hipotekë, të dhëna nga kompani ndërtimi e të tjera.

Çfarë thotë ligji?

Në bazë të Ligjit për Tatimin në pronë e paluajtshme, i cili është ndryshuar, plotësuar dhe miratuar në vitin 2018, thuhet se Ministria e Financave menaxhon të dhënat e tatimit në pronë në regjistrat e tatimit në pronë, operon dhe mirëmban regjistrat e tatimit në pronë, publikon informacionet lidhur me tatimin në pronë, kryen vlerësimin e pronës dhe lëshon certifikatat e vlerës së vlerësuar.

Kurse Kuvendi Komunal i çdo komune i cakton tarifatatimoretë mbi pronën në bazë vjetore, në shkallën prej 0.05-përqindësh deri në 1 për qind të vlerës së pronës në treg. Të hyrat nga tatimi në pronë nevojiten për zhvillimin e infrastrukturës së komunës. Nga grumbullimi i këtyre tatimeve investohet në projekte të ndryshme që kanë për qëllim përmirësimin e jetës së qytetarëve të asaj komune.

Ulen lehtë çmimet e naftës dhe benzinës në Shqipëri

TIRANË, 26 JANAR - Një ditë pasi rriti çmimet e karburanteve, Bordi i Transparencës në Shqipëri u mblodh përsëri

dhe vendosi t'i ulë çmimet. Konkretisht nafta do të tregtohet 4 lekë më pak nga vendimi i së mërkurës, në 206

lekë (1.75 euro) për litër. Benzina do të tregtohet me 191 lekë për litër, vetëm një një lek me pak, ndërsa çmimi

i gazit mbetet i pandryshueshëm në 69 lekë/litri. Çmimet e caktuara kanë hyrë në fuqi të enjten.



“Çdo gjë do të rregullohet. E ardhmja e botës është në duart e të gjithëve!”

Letra e jashtëzakonshme që John Lennon i drejtoi partneres së tij Yoko Ono



Pjesëtari legjendar i “The Beatles” John Lennon dhe Yoko Ono, u takuan për herë të parë më 9 nëntor 1966 pas një shfaqje të artistes japoneze në Londër. Lidhja midis të dyve nisi 2 vjet më vonë. Letra më poshtë ofron një përshkrim të shkurtër të historisë së tyre të dashurisë, por mbi të gjitha të idealeve që ata ndanin. “Gjatë 10 viteve të fundit, kemi zbuluar se gjithçka që dëshironim u bë realitet në kohën e vet, për mirë a keq, dhe në një mënyrë apo tjetrën. Vazhduam që t’i thoshim vetes që një nga këto ditë duhet të organizohemi dhe të dëshirojmë vetëm gjëra të mira. Pastaj erdhi në jetë fëmija ynë! Ishim shumë të lumtur dhe në të njëjtën kohë ndiheshim se kishim shumë përgjegjësi mbi shpatulla. Tani dëshirat tona do të ndikonin edhe tek ai. Ndjemë se ishte koha t’i jepnim fund diskutimeve dhe të fillonim rishikimin e mekanizmave tanë të dëshirave: Pastrimi pranveror i

mendjeve tona! Ishte një punë e madhe. Na ndodhi të gjenim në dollapët e vjetër të mendjes sonë gjëra që nuk e dinim se i kishim ende, gjëra që shpresonim të mos i gjenim më kurrë. Gjatë pastrimit, nisëm gjithashtu të vëmë re shumë gjëra që nuk ishin në rregull në shtëpinë tonë: një raft që nuk duhej të kishte qenë kurrë aty ku ishte, një pikturë që kishte nisur të mos na pëlqente më. Po ashtu kishte 2 dhoma të zymta që u bënë më të ndriçuara dhe më të ajrosura kur rrëzuan murin që i ndante. Filluam që t’i duam bimët: dhe të mendosh që në fillim ishim të bindur se bimët na vdhnin ajrin! Filluam të vlerësonim ritmin e furishëm të qytetit, që dikur na shqetësonte. Kemi bërë shumë gabime dhe vazhdojmë të bëjmë. Dikur kemi shpenzuar shumë energji në përpjekje për të arritur diçka që mendonim se dëshironim. Pyesim veten pse nuk mund ta

arrinim atë, por zbuluam se njëri ose të që dy nuk e donim vërtet atë. Një ditë morëm një sasi të madhe çokolatash të dërguara nga njerëz në mbarë botën. “Hej, çfarë është kjo gjë? Ne nuk i hamë gjërat të ëmbla! Kush ishte ai që i dëshiroi?”. Qeshnim. Ne zbuluam se kur të dy donim diçka në unison, kjo ndodhte më shpejt. Siç thotë Bibla, “Aty ku janë mbledhur dy në emrin tim”. është e vërtetë. Dy janë shumë. Një farë pastruese shumë e fuqishme. Ne po fillojmë që të urojmë dhe të lutemi gjithnjë e më shumë. Gjërat që u përpoqëm t’i arrinim në të kaluarën duke bërë shenjë e paqes, tani kërkojmë t’i arrijmë përmes dëshirës. Nuk e bëjmë sepse është më e thjeshtë. Dëshira është më efektive sesa valëvitja e flamujve. Ajo funksionon, tamam si një magji. Magjia është e thjeshtë dhe e vërtetë. Sekretit është të dish se është e thjeshtë, dhe të mos e

vrasësh atë me rituale të sofistikuara, të cilat janë një shenjë pasigurie. Kur dikush zemërohet me ne, ne vizatojmë me mendjen tonë të një aureolë rreth kokës së tij. Dhe pastaj ai pushon së zemëruari me ne? Epo, nuk e dimë. Por nga ana tjetër e dimë se meqë vizatojmë aureolën rreth tij, se befasi ai nis të na duket si një engjëll. Kjo na ndihmon të ndiejmë dashuri për njerëzit, na kujton se secili ka të mirat e veta brenda, dhe se të gjithë njerëzit që vijnë tek ne janë engjëj të maskuar që na sjellin dhuratat dhe mesazhe nga Universi. Magjia është logjikë. Provojeni ndonjëherë. Kemi ende një rrugë të gjatë për të përshkuar. Duket sikur sa më shumë pastrojmë, aq më shpejt funksionon procesi i dëshirimit dhe pranimit të gjërave. Tani shtëpia është bërë shumë komode. Sean është shumë i bukur. Bimët po rriten. Macet gërhasin të kënaqura.

Qyteti shkëlqen, qoftë në kohe me diell, shi apo borë. Ne jetojmë në një univers të bukur. Jemi mirënjohës çdo ditë për plotësinë e jetës sonë. Dhe nuk e them si klishe. Ne e dimë se qyteti, vendi, bota po përballen me kohë shumë të vështira, dhe në ajër ndihet një atmosferë terrori. Por dielli ende shkëlqen, ne jemi ende bashkë. Midis nesh ka dashuri, dhe po ashtu në qytetin tonë, në fshat, nëpër botë. Nëse dy njerëz si ne po jetojnë në këtë mënyrë, çdo mrekulli është e mundur! Është e vërtetë, tani do të na duhej një mrekulli të madhe. Çështja është t’i pranojmë ato kur ndodhin dhe të jemi mirënjohës për to. Fillimisht ato shfaqen në një formë të reduktuar, në jetën e përditshme, pastaj vijnë në forma të mëdha, si lumenj dhe oqeanë. Çdo gjë do të rregullohet! E ardhmja e botës është në duart e të gjithëve”.

Një Jork, 27 maj 1979.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT Enveri PILKINGTON
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Rrahmani: Nëse vazhdojmë kështu e fitojmë 'Scudetton'

NAPOLI, 26 JANAR - Kapiteni i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Amir Rrahmani, po shkëlqen me fanellën e Napolit në këtë edicion. Futbollisti "dardan" është ndër pikat më të forta të klubit italian i cili po ecën sigurt drejt titullit kampion në Serinë A. Rrahmani për

"Radio Kiss Kiss Napoli" nuk e fsheh dëshirën për ta fituar "Scudetton" dhe për të shkuar sa më larg në Ligën e Kampionëve. "Jemi në gjysmë të rrugës. Mund ta shqiptojmë fjalën 'Scudetto'. Kanë mbetur edhe shumë ndeshje dhe ne po përgatitemi lojë pas loje. Nuk mendojmë për

fundin. Mund ta fitojmë titullin vetëm nëse i zhvillojmë ndeshjet ashtu siç dimë. Nuk ka nevojë për fjalë. Sa i përket Ligës së Kampionëve, besojmë në objektivin për ta arritur çerekfinalen. E kemi bërë një rrugëtim të madh. Shpresojmë të bëjmë diçka të shkëlqyeshme",

ka thënë Rrahmani për "Radio Kiss Kiss Napoli". Ish-mbrojtësi i Prishtinës, Drenicës dhe Dinamo Zagrebit ka kujtuar edhe kohën e vështirë kur ishte i lënduar, por ai është ringjallur nën drejtimin e Luciano Spallettit, të cilin e ka lartësuar për punën që po e bën



me ekipin. Gjithashtu, i ka falënderuar edhe tifozët për mbështetjen që po ia japin ekipit.

KF Llapi përfundon përgatitjet në Turqi, kthehet në Kosovë



Prishtinë, 26 janar - Skuadra e Llapit të enjten në mëngjes e ka zhvilluar stërvitjen e fundit në Antalya të Turqisë, me çrast ka përfunduar kampin përgatitor

prej dhjetë ditësh. Futbollistët e drejtuar nga trajneri Tahir Batatina gjatë këtyre ditëve kanë punuar me përpikëri sipas detyrave të shtabit teknik dhe

kanë treguar angazhim e disiplinë maksimale dhe profesionalizëm si në stërvitje ashtu edhe në ndeshje. "Brenda kampit 'bardhekaltër' ka mbretëruar një atmosferë

fantastike nga dita e parë e deri në ditën e fundit dhe kjo tregon se futbollistët që ishin nga sezoni i kaluar dhe ardhjet e reja janë lidhur edhe më shumë me njëri-

tjetrin", thuhet në njoftimin e skuadrës llapjane. KF Llapi seancën stërvitore e zhvilloi në kompleksin e fushave "Asteria" dhe në fund të stërvitjes shtabi teknik ka organizuar një ndeshje ndërmjet tri-ekipeve dhe në fund fitues ka dalë ekipi i udhëhequr nga Gerhard Progni. Ekspedita e Llapit pas përfundimit të përgatitjeve të enjten në mbrëmje u rikthye në Kosovë.

Raddy Ovouka përforcon Dritën

Skuadra lidere në Superligën e futbollit të Kosovës, Drita, e ka zyrtarizuar transferimin e Raddy Ovouka. Ky i fundit e përforcon skuadrën gjilanase në formë huazimi nga klubi ganez Hearts of Oak. "Ovouka do të jetë pjesë e klubit tonë për një vit në formë huazimi nga klubi ganez Hearts of Oak. Raddy është 23-vjeçar dhe luan si mbrojtës i majtë, së fundmi ka qenë pjesë e ligës amerikane USL Championship te skuadra New Mexico United", thuhet në njoftimin e Dritës.

Sorschag: Krenare që do ta përfaqësoj Kosovën

PRISHTINË, 26 JANAR - Në Trieste të Italisë është nënshkruar kontrata në mes të Federatës Skitare të Kosovës dhe skitaires Sophie Sorschag. 24-vjeçarja garon në kërcime me ski, disiplinë në të cilën është kampione e botës në ekipore me Austrinë, shtet për të cilin ka garuar deri në Lojërat Olimpikë Dimërore "Pekini 2022". Në ceremoni ishin drejtuesit e

KOK-ut me presidentin Ismet Krasniqi, kryetari i FSK-së, Milaim Kelmendi, njëherësh nënpresident i KOK-ut, skitarja Sorschag, trajneri i saj, Jure Radelj, prindërit e Sorschag dhe miq sllovenë të cilët ndihmuan në arritjen e kësaj marrëveshje. Sorschag u shpreh krenare që do të ketë mundësinë të garojë për Kosovën, për çka i falënderoi të

gjithë për mikpritjen e ngrohtë, po ashtu trajnerin dhe familjen që e kanë mbështetur në këtë vendim. "Jam shumë krenare që do ta përfaqësoj Kosovën në gjithë botën në kërcimet me ski. Faleminderit gjithë popullit të Kosovës që më ka bërë pritje të ngrohtë ditët e fundit e të cilën nuk e kam pasur më parë", ka thënë Sorschag.



Lirika Deva dhe Enxhi Sefaj përfundojnë garat në Itali

Venezia, 26 janar - Skitaret e reja të Kosovës, Lirika Deva dhe Enxhi Sefaj, e kanë mbyllur garimin në EYOF Friuli Venezia Giulia 2023. Ato kanë garuar të

enjtën në disiplinën e sllallomit të madh. Për dallim nga gara e së mërkurës e sllallomit, ku u diskualifikuan, patën paraqitje të kënaqshme, marrë për bazë

kushtet në të cilat zhvillohet skijimi në Kosovë. Deva u rendit e 44-ta prej 88 garueseve, 34 prej të cilave dolën nga shtegu, ndërsa Sefaj e 51-ta. Sot

(e premte) do të garojë Klos Vokshi në disiplinën e sllallomit të madh, me të cilin edhe mbarojnë garat për ekipin e Kosovës.



Hamiltoni: Jam piloti më i mirë që ka pasur ndonjëherë në Formula 1

LONDËR, 26 JANAR - Në startin e këtij sezoni të Formulës 1 do të jetë edhe piloti britanik Lewis Hamilton, shtatë herë kampion bote, që do të garojë me makinën Mercedes. Ai është një pilot që ka kaluar shifrën e 300 garave në këtë sport. Statistikat tregojnë se

pilotët, pasi arrijnë kuotën e 300 garave, nuk fitojnë dot më, tabu që këtë vit synon ta thyejë Hamiltoni. "I di aftësitë e mia dhe të makinës time, ndaj mendoj se mund t'ia dal mbanë", ka thënë Hamiltoni, që mban mjaft rekorde në këtë sport. "Ju garantoj se në

Formula 1 nuk ka pasur kurrë më parë një pilot si unë", u shpreh më tej Lewis Hamiltoni, që përgatitet për një tjetër sezon të vështirë, duke qenë se Mercedesi nuk është favorite. Gjashtë janë pilotët që kanë kaluar kuotën e 300 garave në Formula 1: Fernando Alonso,

Kimi Raikkonen, Michael Schumacher, Rubens Barrichello, Lewis Hamilton e Jenson Button (Vettel 299 gara), por pasi kanë arritur këtë shifër nuk kanë fituar dot më. Nga kjo gjashtëshe, vetëm Barrichello nuk është shpallur dot kampion bote.



Lillard realizon 60 pikë në fitoren e Portlandit, humbasin Denveri dhe Brooklyn

PORTLAND, 26 JANAR - Milwaukee korr fitoren e dytë radhazi dhe tregon forcën ndaj Denverit, duke fituar me rezultat 107-99. Për miqtë mungoi Nikola Jokiq, ndërkohë që Antetokounmpo realizoi 33 pikë e 14 rebounde për Bucksin, që ngjitet në vendin e tretë në Lindje. Humbet edhe Memphis, që u mund me rezultat 122-120 nga kampionët e Golden States. Për Warriorsin u dallua Stephen Curry me 34 pikë. Lakersat rikthehen te fitorja, duke mundur me rezultat 113-104 San Antonion. LeBron Jamesi realizoi 20 pikë e 11 asistime, ndërkohë që u rikthye



nga dëmtimi Davis, që e nisi ndeshjen nga stoli (21 pikë e 12 rebound). Philadelphia, falë 27 pikëve të Maxey dhe 26 pikëve e 10 reboundeve të Embiidit, mundi me rezultat 137-133 Brooklynin (Irvingu 30 pikë), dy ekipe që janë në zonën "play-off" në Lindje. Në takimet e tjera të luajtura, Portlandi mundi me

rezultat 134-124 Utah Jazzin, ndeshje ku shkëlqeu Damian Lillard, autor i 60 pikëve, në një ndeshje të jashtëzakonshme. Fitoi edhe Orlando, që mundi me rezultat 126-120 Indianan (Banchemo 23 pikë), ndërsa Toronto fitoi me rezultat 113-95 në shtëpinë e Sacramento (Siakam 26 pikë e 11 rebounde).

REZULTATET

Orlando - Indiana	126-120
Philadelphia - Brooklyn	137-133
Houston - Washington	103-108
Milwaukee - Denver	107-99
New Orleans - Minnesota	102-111
Oklahoma - Atlanta	132-137
Golden State - Memphis	122-120
Portland - Utah Jazz	134-124
Sacramento - Toronto	95-113
Lakers - San Antonio	113-104

Berisha, vendimtar në fitoren e Augsburgut: Morëm tri pikë të rëndësishme

AUGSBURG, 26 JANAR - Mërgim Berisha ia siguroi fitoren Augsburgut në Bundesligë. Sulmuesi kosovar e shënoi golin vendimtar ndaj Borussia Monchengladbachut, i cili e largon ekipin e tij nga zona e ekipeve të rrezikuara për të rënë nga liga. Futbollisti nga Suhareka në fakt e realizoi një gol akrobatik në minutat e fundit të lojës. Kjo ishte hera e parë që Augsburgu fitoi në shtëpi që nga shtatori i vitit të kaluar, kur pikërisht me golin e Berishës e kishte mposhtur gjigantin Bayern Munchen. Ky ishte goli i katërt sezonal për Berishën në 11 ndeshje të zhvilluara deri tash në ligën elitare gjermane, ndërsa ai i ka edhe katër asistime. Futbollisti në pronësi të Fenerbahçes ndihet i lumtur me fitoren dhe



me golin e radhës. "Ishte një paraqitje mjaft e mirë nga ana jonë. U mbrojtëm mirë si ekip dhe i krijuam disa raste. Jam i lumtur që e ndihmova ekipin me golin tim. Por, fakti se ne fituam, është gjëja më e rëndësishme", ka deklaruar ish-

futbollisti i Salzburgut. Falë kësaj fitoreje, Augsburgu iu shmang përkohësisht zonës së ekipeve që do të bien nga liga. Berisha synon ta shpëtojë ekipin e tij dhe shpreson që ta vazhdojë karrierën në Gjermani.

SHKURT

Joshua më 1 prill kthehet në ring

Anthony Joshua do të kthehet në ring kundër Jermaine Franklin më 1 prill në "O2 Arena". Ish-kampioni i peshave të rënda pësoi humbje të njëpasnjëshme ndaj Oleksandr Usyk, duke dështuar në rimeçin e gushtit të vitit të kaluar pasi humbi titujt ndaj ukrainasit të pamposhtur në shtator të vitit 2021. Në rikthimin e tij ai do të ballafaqohet me Franklin që do të jetë testi i tij i parë nën trajnerin e ri Derrick James, raporton "Daily Mail". Franklin erdhi në Londër nëntorin e kaluar për t'u përballur me Dillian Whyte, një luftë që përfundoi në të mirë të këtij të fundit pas vendimit të gjyqtarëve. Jermaine ka fituar më parë të gjitha 21 meçet e tij profesionale, duke eliminuar 14 kundërshtarët e tij. Ai do të përballlet me një luftëtar të etur për t'u rikthyer në rrugët e fitoreve si Joshua, i cili tani ka humbur tre nga pesë meçet e tij të fundit që datojnë nga humbja e tij tronditëse ndaj Andy Ruiz Jr në verën e vitit 2019.

Pesë futbollistë pritet të largohen nga City

Pesë futbollistë nga ekipi i parë i Manchester Cityt pritet të largohen në verë. Klubi anglez pritet ta rifreskojë skuadrën e tyre dhe gazetari spanjoll Jose Alvarez ka hedhur dritë mbi një numër prej atyre që mund të largohen. Alvarez ka thënë se Ilkay Gundogan, Bernardo Silva, Kyle Walker, Joao Cancelo dhe Aymeric Laporte janë kandidatët më të mundshëm për t'u larguar nga "Etihad Stadium". Trajneri Pep Guardiola njihet se është i hapur për t'i lënë lojtarët të largohen nëse nuk janë të kënaqur me gjendjen e tyre të vështirë. Nga City në verën e kaluar janë larguar yjet si Raheem Sterling, Gabriel Jesus dhe Oleksandr Zinchenko.

Modriqi refuzon ofertën e Al Nassrit

Skuadra arabe Al Nassr nuk e ka ndër mend të ndalet vetëm me marrjen e yllit botëror Cristiano Ronaldo, por synon edhe emra të tjerë të njohur nga futbollit evropian. Së fundi u raportua se ata po provojnë ta rrëmbejnë mesfushorin kroat Luka Modriq nga Real Madridi, por kjo duket se nuk do të ndodhë. Sipas "Marca"-s, mesfushori i Real Madridit ka refuzuar ofertën e klubit të Arabisë Saudite që kërkuan ta merrnin atë pas përfundimit të këtij sezoni. Me kontratën e Modriqit që skadon në fund të sezonit, Al Nassr shpresonte ta ribashkonte atë me ish-shokun e skuadrës Cristiano Ronaldo dhe thuhet se po ofronte një pagë prej 40 milionë eurosh në vit. Megjithatë, legjenda kroate duket se do të vazhdojë te Real Madridi edhe për një sezon tjetër.

Zaniolo, afër kalimit në Milan

AC Milan është shumë afër transferimit të sulmuesit italian Nicolo Zaniolo. Sipas "Sportmediaset", sulmuesi 23-vjeçar është i vendosur për ta vazhduar karrierën e tij në Milano. Tashmë Paolo Maldini është në pritje të miratimit përfundimtar nga pronari i klubit kuqezi, Gerry Cardinale. Marrëveshja në mes të Milanit dhe Romës pritet të jetë për një shifër totale prej 25 milionë eurosh. Kërkesa e verdhekuqëve fillimisht ishte me vlerë prej 35 milionë eurosh për ta lënë të lirë Zaniolon, por mesa duket duhet të kënaqet me ofertën e Milanit. Ditët e fundit në afatin kalimtar për sulmuesin italian ka qenë dhe Tottenham Hotspur, por pa një ofertë zyrtare.

Low, Pochettino dhe Villas-Boas në listën e Belgjikës

Kombëtarja e Belgjikës pas gjashtë vjetësh është ndarë me trajnerin Roberto Martinez, derisa tash është në kërkim të një trajneri të ri.

"Daily Mail" raporton se në listën e dëshirave të drejtuesve të kombëtares belge janë tre emra të njohur: Low, Pochettino dhe Andre

Villas-Boas. Low është trajneri i vetëm që ka përvojë në drejtimin e një ekipi përfaqësues. 15 vjet në krye të Gjermanisë e bëjnë atë

kandidatin kryesor. Një tjetër emër i rëndësishëm është edhe Pochettino, ish-trajner i Tottenhamit dhe PSG-së, të dy janë trajnerë të lirë. I treti

në listë është Andre Villas-Boas, dikur një nga emrat më premtues, por vitet e fundit ka preferuar paratë dhe jo klube të njohura.

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/Prishtinë
Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate

Departamenti për Burime Njerëzore

Në bazë të Ligjit për Policinë, kreu V, neni 44, Ligjin e Punës Nr. 03/L-212, kreu II, neni 8, Ligji për Barazi Gjinore nr. 05/L-020, neni 5 dhe 6, Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi nr. 05/L-021, neni 7, Udhëzimin Administrativ 01/2021 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, kapitulli III neni 8, neni 9 pika 1 dhe 2, dhe Vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm datë 04.01.2023 me nr. ref: DBN 07/01/2023, Policia e Kosovës:

VAZHDON AFATIN E KONKURSIONIT

Të publikuar nga data 05.01.2023 deri me datë 26.01.2023 për pranimin e zyrtarëve policorë sipas kushteve të parapara të konkurrimit për të gjitha minoritetet (Serb, Boshnjak, Turq, Goran, Romë, Ashkali, Egjiptas, Kroat, Malazez, Maqedonas).

Titulli i vendit të punës: Zyrtar Policor
Vendi i punës : Drejtoria Rajonale e Policisë Mitrovicë Veri

Afati për paraqitjen e aplikacioneve vazhdohet për dhjetë (10) ditë duke filluar nga data **27.01.2023** deri me datë **10.02.2023**.

Vëmendje: Kriteret në konkurs mbeten të njëjta si dhe kandidatët të cilët kanë konkurruar në këtë konkurs nuk është e nevojshme të aplikojnë përsëri.

Aplikimi bëhet në formën fizike që nënkupton se aplikacioni duhet të shkarkohet nga faqja zyrtare e Policisë së Kosovës në adresën www.kosovopolice.com / Shpallje/Mundësi punësimi Aplikacioni i plotësuar së bashku me dokumentet tjera mund dërgohet fizikisht në stacionin më të afërt të Policisë ose të dërgohet përmes postës elektronike (email) në adresën: rekrutimi@KosovoPolice.com.

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/Prishtinë
Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate

Uprava za Ljudske Izvore

Na osnovu Zakona o Policiji, poglavlje V, član 44, Zakona o radu br. 03/L-212, poglavlje II, član 8, Zakon o ravnopravnosti polova br. 05/L-020, član 5 i 6, Zakona o zaštiti od diskriminacije Br. 05/L-021, član 7, Administrativno Uputstvo 01/2021 o Radnom Odnosu u Policiji Kosova, poglavlje III član 8, član 9, tačka 1 i 2, i Odluka Generalnog Direktora od 04.01.2023 pod referentnim br: DBN 07/01/2023, Policijska Kosova:

PRODUŽENJE ROKA KONKURSA

Objavljen od 05.01.2023 do 26.01.2023 za prijem policijskih službenika po prethodnim uslovima konkursa za sve manjine (Srbe, Bošnjake, Turaka, Goranaca, Roma, Aškalije, Egipčane, Hrvate, Crnogorce, i Makedonce).

Naziv radnog mesta: Policijski službenik
Radno mesto: Regionalna Direkcija Mitrovica -Sever

Rok za prijavu aplikacija je produžen za još deset (10) dana, počevši od **27.01.2023** do **10.02.2023**.

Pažnja: Kriterijumi na konkursu ostaju isti, i kandidati koji su konkurisali na ovom konkursu ne moraju da se ponovo prijave .

Aplikanje se obavi na fizičkom obliku, što podrazumeva da se aplikacija mora preuzimati sa službenog sajta Policijske Kosova na adresu www.kosovopolice.com / Oglas/Mogućnosti zapošljavanja. Popunjena aplikacija zajedno sa drugom dokumentacijom mogu se fizički proslediti na naj bliskoj Policijskoj Stanici ili da se dostave preko elektronske pošte (email) na adresu: rekrutimi@KosovoPolice.com.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINE SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA

DREJTORIA E ARSIMIT
05n. 111-6504 datë 26.01.2023

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të punës nr.03/L-212, neni 35 të Ligjit për arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës me nr. 04/L-032, neni 5 të Ligjit për arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës nr.03/L-068, UA nr.05/2021 (Normativit mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm),UA nr.08/2021 ,Udhëzimit administrativ nr.07/2017 për rregullimin e procedurave për themelimin e mardhënies së punës në sektorin publik, Drejtoria Komonale e Arsimit shpall këtë:

KONKURS
Për plotësimin e vendeve të lira të punës

- SHFMU "7 Marsi"-Suharekë**
Një mësimdhënës/e për lëndën e edukatës fizike
- SHFMU "Naum Veqilharxhi"-në Mohlan**
Një mësimdhënës/e për lëndën e TIK-ut.
- SHFMU "Vaso Pashë Shkodrani"-Leshan**
Një mësimdhënës/e për lëndën e TIK-ut
- SHFMU "Dëshmorët e Greikocit"-në Greikoc**
Një mësimdhënës për lëndën e fizikës
- SHFMU "Edit Durham"-në Mushtisht**
Një mësimdhënës/e për mësim klasor (zëvendësim i pushimit të lehonisë)
- IP "Fluturat"-Suharekë**
Dy edukatore për paralelen në Sopijë (zëvendësim të pushimit të lehonisë)
- SHFMU "Lidhja e Prizrenit"-Budakovë**
Një punëtor teknik/ndihmës

Kushtet: Për këto vende të lira të punës të shpallura në konkurs kërkohet përgatitja adekuate profesionale sipas normativit UA-MASHT nr.05/2021 dhe UA-MASHT nr.08/2021

Dokumentacioni i nevojshëm për konkurrim:

- Formulari i aplikimit (kërkesa) të cilën e plotëson kandidati
- Ekstrakti i lindjes
- Letërnjoftimin (fotokopje)
- Dëshmi që nuk jeni nën hetime.
- Diploma e shkallës së kualifikimit ose certifikata në vend të diplomës e cila nuk duhet të jetë më e vjetër se gjashtë muaj (fotokopje).
- Kandidatët të cilët kanë diplomuar jashtë Republikës së Kosovës ,duhet t'i kenë diplomat e nostrifikuar nga Minsitria e Arsimit,Shkencës ,Teknologjisë dhe Inovacionit.
- Dëshmia e përvojës së punës në arsim, (nëse ka)
- Certifikatat për trajnimet e kryera të akredituara nga MASHTI(nëse ka)

Dokumentet e kompletuara dorëzohen të fotokopjuara, ndërsa dokumentet origjinale prezantohen në intervistë. Dokumentet e pakompletuara dhe ato që arrijnë pas afatit nuk merren në shqyrtim nga komisioni. Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Zyren Pritëse në Komunën e Suharekës. Afati për pranimin e aplikacioneve është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data **27.01.2023** deri me datë **10.02.2023**.

Për orarin e intervistimit do të informoheni në faqen zyrtare të Komunës së Suharekës dhe tabelën e shpalljeve të DKA-së.

Drejtori i DKA-së
Remzi Bajselmani

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINE SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA

DIREKCIJA ZA OBRAZOVANJE
05 br. 111-6504 od 26.01.2023 godine

Na osnovu člana 8 Zakona o radu br.03/L-212, člana 35 Zakona o preduniverzitetskom obrazovanju u republiku Kosova br.04/L-032, člana 5 Zakona o obrazovanju u opštinama Republike Kosovo br.03/L-068,AUbr.05/2021,AUbr.08/2021 (Normariva u stručnim kadrovima opšteg obrazovanja), Administrativnog uputstva br.07/2017 o regulisanju procedura za osnivanje radnog mesta u javnom sektoru,Opština direkcija za obrazovanje objavljuje:

KONKURS
Za popunu slobodnih mesta

- OSNŠ "7 Marsi"- Suva Reka**
Jedan nastavnik/ca za predmet fizičko vaspitanja
- OSNŠ "Naum Veqilharxhi"-Movlane**
Jedan nastavnik/ca za predmet TIK
- OSNŠ " Vaso Pashë Shkodrani"-Lešane**
Jedan nastavnik/ca za predmet TIK
- OSNŠ " Dëshmoret e Greikocit"-Greikoce**
Jedan nastavnik/ca za predmet fizika
- OSNŠ " Edit Durham "-Muštište**
Jedan nastavnik/ca za razredu nastavu (zamena za nastavnicu porodiljsko odsustvo)
- Dečji vrtić "Fluturat"-Suva Reka**
Dve vaspitačicu za odeljenje u Sopije (zamena za nastavnicu porodiljsko odsustvo)
- OSNŠ " Lidhja e Prizrenit"-Budakovë**
Një punëtor teknik/ndihmës

Uslovi: Za ova slobodna radna mesta obavljena na konkursu potrebna je odgovarajuća stručna sprema prema normative AU MONT br.05/2021 ,AU br.08/2021.

Dokumentacija potrebna za konkurs:
-Obrazac (prijava) kokandidat popunjava
-Ekstrakt rodenja
-Lična karta (fotokopija)
-Potvrda za obuke akreditovane od MONT-a (ako ga ima)
-Dokaz da nije pod istragom
-Dokaz o Radnom iskustvu u obrazovanju(ako ga ima)
- Osobe koje su diplomirale van Kosova moraju imati nostrifikovane diplome MONT-a
Kopletirane dokumenti se dostavljaju u fotokopirano,dok će se originalni dokumenti podstavljavati u intervju.Komisija neće razmatrati nepotpune i dokumenta prispela nakon isteka roka.Prijave se primaju i predaju u Prijemnu Kancelariju u Opštine Suva Reka.

Konkurs ostaje otvoren 15 (petnaest) dana od 27.01.2023 do 10.02.2022.
Orasporedu intervju bićete obavešteni na web stranici Opštine Suva Reka i oglasnoj table ODO.

Direktor Obrazovanje
Remzi Bajselmani

Thirrja për aplikim (DHËNJE TË OFERTËS)

SHPETIM ZABELI B.I. me numer **Unik:81199139** Adresa:Rr.Arben Haliti nr.105 Komuna Skënderaj me pronal Shpetim Zabeli, po kërkon një ofertues/kontraktor/kompani të interesuar dhe të kualifikuar që të dorëzojë një ofertë/propozim për **mallrat/punët/shërbime** këshilluese si në vijim:për kompanit e Interesuara për Ofertim të këtyre **Puneve dhe paisjve** :Ndertimi i serres 2100m2 dhe paisjeve percjellëse

1. Ndertimi i serres per prodhimin e fidaneve 2100m2
2. Instalimi I sistemit te ujtjes automatike me software
3. Hapja e pusit per ujtje
4. Makina per mbjelljen e farave
5. Stufa 200kwme lende punuese me thengjill me system vetmbushes automatic me thengjill dhe manuel system elektrik te instaluar per kontrollimin e temperatures dhe pompave qarkulluese te ujit.
6. Pompa qarkulluese te ujit me kapacitet 700 w
7. Ena ekspanduesde 200 L
8. Akumulues i ujit te nxeht 1000 L
- 9.Furnizimi dhe instalimi I gypave te ujit me system te gypave te metalit fi90 dhe elementet tjera montuese.
10. Gypat shperndares te sistemit te ujit ne serre gypa special plastic fi 60,200m
11. Shperndarja e rrjetit te nxemjes ne serre me gypa special per nxemje ne serre gypa me rrath fi 28,2000m.
12. Elemente per montimin e gypave-klampa special dhe lidhese,50 cop
- 13.Furnizimi dhe montimi I oxhakut 8m.
- 14.Furnizimi dhe montimi I kalorifereve per qarkullimin e ajrit dhe nxemje me kapacitet 10 kw,6 cop
- 15.Kryerja e puneve nga nje pale e tret ne instalimin e nxemjes dhe instalimin e elektrikes.
- 16.Energji e ripertritshme kw komplet

Kompanitë e interesuara duhet të kontaktojnë direkt tek **SHPETIM ZABELI B.I.** (Përfutuesi) nëpërmjet e-mailit apo telefonit për të kërkuar një Ftesë për Kuotim tek adresa e cekur më poshtë

Afati për të kërkuar një Ftesë për Kuotim/sqarime tek adresa e cekur më poshtë (5 ditë nga data e publikimit)

Afati i dorezimit të Ofertave **10 ditë nga data e pranimit te ftesave** per kuotim, ofertat dorëzohen ne Adresen: rruga ARBEN HALITI nr.105 Komuna SKENDERAJ
Për Informata Shtesë tel: **+383 44 350 464** dhe në email adresën: **zabelishpetim@gmail.com**

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Ndërmarrja e Re IBG Industria e Bativerive Gjilan SH.P.K. shoqëri me përgjegjësi të kufizuara me nr. Unik Identifikues 810813156 bënë shpallje në gazet për zvogëlimin e kapitalit nga 3,255,513,00 në zero.

- Bardh Kupa nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e e kl. 10,11,12 Të Gjimanzit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Redona Salihi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10 të Gjimnazit "Hajdar Dushi".

- Vllaznim Sylja nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shm Teknikë "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Ahmet Sadriqaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shm Teknikë "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Elza Duraku nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10,11,12 diplomën dhe certifikatën e maturës të gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Nexhmedin Kuqi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shm Ekonomike "Kadri Kusari" drejtimi Hotileri Gjakovë.

- Eduard Pnishi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl, 10,11,12 të shm Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Vesel Kadriqaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfm " Lidhja e Prizrenit " Prizren.

- Enver Doli nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e ssh.m. Teknikë "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Hidajete Rexhaj nga Guska KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të shf "Pjetër Muqaj" Gusk KK Gjakovë nga kl. I-VIII.

- Artan Dylhasi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I,II,III,IV dhe diplomën e shm Teknikë "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Beshik Gashi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të shf "Zekiria Rexha" Gjakovë nga kl. I-VIII.

- Isa Popaj shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknikë "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Nazmije Berisha nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 11 të shm Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.

- David Mirdita nga Glllogjani KK Pejë shpall të pavlefshme diplomën e Qendrës Arsimore "Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcejllëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook www.facebook.com/gjeipuneshpejte



RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]


- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



PASHTETË PULE

MEKA
HALAL FOOD

gluten
free



cilësi e garantuar

pa konservues